



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 2580 Prot.

Fier më 27 /02/2025

Projekt - Vendim

Nr. 24 Dt. 27.02.2025

“Për miratimin e planvendosjes së strukturës për projektin “ Rehabilitimi I Lumit Gjanica Faza 3 , Fier” per efekt të vazhdimit të procedurave për pajisjen me leje infrastrukture dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt..../...../2025, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Hartimit të Projekteve dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Pronave , në lidhje me hartimin e Planvendosjes së Strukturës “ Rehabilitimi I Lumit Gjanica faza 3 “ , me treguesit e zhvillimit të propozuar , njësia srukturore 1/50 , ku pasqyrohet skema e vendosjes së zonës së zhvillimit dhe pozicioni kadastral pasurive te paluajtshme,Zona Kadastrale ZK Nr.8531, per efekt të vazhdimit të procedurave për pajisjen me leje infrastrukture si dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të evidentimit të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik”. Ky projekt është miratuar dhe financuar në kuadër të bashkëpunimit institucional me Fondin Shqiptar të Zhvillimit , në kuadër të aplikimit për projekte “ Rigjenerimi urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur etj,Rajonet 3&4 me interes publik dhe realizimi I elementeve te tjere te infrastruktures urbane do te kete impakt te ndjeshem ne permiresuimin e cilesise se ajrit .

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015,”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma “a” dhe gërma “b”, Ligjin Nr.107 , date 31/07/2014 “ Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit , I ndryshuar dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij bazuar në nenin 54, gërma “k”, Kryetari I Bashkisë :

Propozon :

1-Të miratohet planvendosja e strukturës për projektin “ Rehabilitimi I Lumit Gjanica Faza 3 , Fier” per efekt të vazhdimit nga ekzekutivi të procedurave për pajisjen me leje infrastrukture, sipas planvendosjes bashkëlidhur;

2.Të autorizojë ekzekutivin e Bashkisë për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik .

Drejtoria e Projekteve të Infrastrukturës

Dr. H. Avdullai

Drejtoria e Pergjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Dr.F.Troka

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Dr. A.Behari

Drejtoria Juridike

Dr. E. Kapllanaj

KRYETARI
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Vasil Bregu

